



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1520/6 prot.

Datë 22.07.2024

V E N D I M
Nr. 937/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.07.2024, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-96925-02-29-2024 me objekt “Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet” me fond limit 15,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21-05-2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë SH.A.

Ankimues: BOE “Infosoft Systems” SHPK me NIPT J61820021C & “Info Business Solutions” SHPK me NIPT L02214022G
Adresa: Rruga Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë SH.A
Adresa: Qafë-Gjashtë, Sarandë, Rruga “Skënderbeu”

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK me NIPT L12121023B dhe adresë Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 01-03-2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-96925-02-29-2024 me objekt “Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet” me fond limit 15,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar

në datën 21-05-2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A.

II.2. Në datën 21.05.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 03.06.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Infosoft Systems” SHPK & Info Business Solutions” SHPK 11,880,000 leke pa tvsh skualifikuar
2. “Kreatx” SHPK 13,455,000 lekë pa tvsh kualifikuar

II.4. Në datën 04.06.2024, në Sistemin e Prokurimit Elektronik autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim Fituesi për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 10.06.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1520/2024 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4188 e operatorit ekonomik BOE “Infosoft Systems” SHPK & Info Business Solutions” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1520/2 prot., datë 11.06.2024, duke publikuar arsyet e skualifikimit të BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK si vijon:

“[...]

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 *Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere jo me te ulet se 40% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte: Operatori ekonomik B O E : “ (JV) Infosoft System shpk NIPT J 61820021 C & Info Business Solutions shpk NIPT L 02214022 G “ ne te gjithë kontratat e ngarkuara ne sistem nuk provon ne asnje moment sherbimet e leximit dhe te aplikacionit te leximit te pajisjeve PDA. Gjithashtu kjo B O E : “ (JV) Infosoft System shpk NIPT J 61820021 C & Info Business Solutions shpk NIPT L 02214022 G “ nuk ka paraqitur asnje kontrate te ngjashme per shitje te pajisve PDA. Te dy keto zera e mesiperme pamvarsisht % ne marrveshje ne asnje nga dokumentat nuk provojne qe kane kontrata te ngjashme te dy kompanite.*

2.3.5 Operatori ekonomik B O E : “ (JV) Infosoft System shpk NIPT J 61820021 C & Info Business Solutions shpk NIPT L 02214022 G “ nuk e ploteson kete pike te DST si me poshte: Operatori ekonomik B O E : “ (JV) Infosoft System shpk NIPT J 61820021 C & Info Business Solutions shpk NIPT L 02214022 G “ nuk ka paraqitur asnje dokument nga prodhuesi si per aplikacionin e PDA. Ne asnje nga dokumentat nuk paraqitet si emri aplikacionit ashtu dhe autorizimi I prodhuesit. Ne propozimin teknik qe B O E : “ (JV) Infosoft System shpk NIPT J 61820021 C & Info Business Solutions shpk NIPT L 02214022 G “ ka paraqitur, eshte marre kopje e te gjitha specifikime teknike qe kerkohet nga autoriteti dhe nuk permendet ne asnje nga dokumentat emri i aplikacionit i ofruar nga ana e kesaj B O E.

2.3.6 APP mobile i lexuesve duhet te jete i certifikuar per pajisjen PDA te ofertuar.

-Ky kriter do te konsiderohet i permbushur me dorezimin deklarates dhe certifikimit nga prodhuesi i PDA. Operatori ekonomik B O E : “ (JV) Infosoft System shpk NIPT J 61820021 C & Info Business Solutions shpk NIPT L 02214022 G “ ne dokumentacionin e paraqitur nga ana e prodhuesit me ane te nje deklarate nuk cilesohet aplikacioni qe eshte ne perputhje me pajisjen qe ofron prodhuesi per kete procedure pamvarsisht qe prezupozohet qe ky aplikacion ka kaluar te gjitha testet per kete pajisje. Gjithashtu Operatori ekonomik B O E : “ (JV) Infosoft System shpk NIPT J 61820021 C & Info Business Solutions shpk NIPT L 02214022 G “ nuk ploteson specifikimet teknike per pajisjet PDA qe sipas autorizimit te prodhuesit eshte PD400 . Sipas skedes teknike e marre nga faqa zyrtare e kompanise prodhuese e cila ka leshuar dhe autorizimin, kjo pajisje nuk ploteson specifikimet si me poshte:

- Mbrojtja IP68 (kerkuar) ne skede eshte 67
- Sensor Drite- Po (ne skede nuk eshte)
- Sensor Graviteti – Po (ne skede nuk eshte)
- Sensor Distance (ne skede nuk eshte)
- Sensor per fushe manjetike – Po (ne skede nuk eshte)
- Sensor Giroskopi – Po (ne skede nuk eshte)
- Minimumi distances se funksionimit te Scannerit 1 m. (ne skede nuk eshte)
- Card Slot: Nano SIM + SIM + Micro SD (ne skede nuk eshte Nano Sim)
- ËiFi: 2.4Ghz/5Ghz/IEEE 802.11 (ne skede nuk perfshihet 5 Ghz qe eshte Ëifi me perdorshimi ne keto momente)
- Mikrofon: Po (ne skede nuk eshte)
- Port: Type C (ne skede nuk eshte)
- Camera: $\geq 13MP$ Mbrapa/ $\geq 5MP$ Para (ne skede eshte vetem 5MP mbrapa, para eshte 0)
- Pesha: $< 245gr$ (ne skede 260)
- Bateria te jete te pakten 3,8V/5000mAh (ne skede eshte 3,7V)
- Pajisja te jete rezistente nga uji deri ne 1.2 metra thellesi (ne skede nuk eshte)

Edhe pse ne dokumenta eshte vendosur dhe nje MAF per operatorin IBS i cili ne % e marrveshjeve nuk ka asnje rol per kete sherbim, edhe ky MAF nuk ploteson specifikimet teknike..”

II.6. Me anë të shkresës Nr. 497 prot., datë 19.06.2024, protokolluar me tonë me nr. 1520/3 prot., datë 24.06.2024, me objekt “Dërgim vendimi, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik B O E : “Infosoft System” shpk & “Info Business Solutions” shpk nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur,

Arsyeton

III.1. Lidhur pretendimin e BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: “[...]Infosoft Systems shpk, ne perputhje me perqindjet dhe zerat qe ajo ka marre persiper te realizoje, si dhe ne perputhje me objektin e kompanise (demostruar ne QKB), ka paraqitur kontrata TE NGJASHME per objektin e prokurimit, ku vertetojme se kemi realizuar shitje dhe sherbime te ngjashme per licenca, mirembajtje dhe pajisje hardëare te te gjitha llojeve. Madje kompleksiteti i kontratave tona, i cili eshte me i larte se ai i kerkuar, duhet ti japi siguri Autoritetit per kapacitete teknike qe ne i zoterojme. Kriterin vlere ne e kemi plotesuar dhe tejkalar sepse jane paraqitur kontrata me komplekse dhe me vlere me te larta. Kriterin afat perseri e kemi plotesuar sepse jane realizuar brenda tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates. Info Business Solutions shpk, ne perputhje me perqindjet dhe zerat qe ajo ka marre persiper te realizoje, si dhe ne perputhje me objektin e kompanise (demostruar ne QKB), ka paraqitur kontrata TE NGJASHME per objektin e prokurimit, ku vertetojme se kemi realizuar shitje, sherbime, integritime, migrime dhe kryesorja zgjidhje softëare-ike te ngjashme. Keto kapacitete jane te njohura nga Autoriteti duke gene se jane zbatuar me sukses pikerisht ne kete autoritet pergjate viteve te shkuara.. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere jo me te ulet se 40% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte:

- per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlere, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.
- per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paraqese fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne

fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

III.1.2 Në shtojcën 5 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 5

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

1.1. Autoriteti Kontraktues Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande Sha 1.2. Situata Aktuale Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande ka ne administrim tre njesi, Sarande, Finiq dhe Konispol. Nisur nga problematikat e hasura ne programin ekzistues nga perdoruesit, amortizimi i serverit, mungesa e datacenter dhe infrastrukture IT te pershtatshme, dhe rekomandimet e AKCESK cili here pas here dergon kerkesa ne lidhje me sigurine ne infrastruktoren e shoqerise, grupi i punes i ngritur ne SHRUKS arriti ne konkluzionin e blerjes se nje licence te nje zgjidhje softëerike komplekse dhe sherbime mbeshtetese ku te jene te perfshira te gjithe proceset e punes se shoqersie dhe konkretisht Lexim, Faturim, Arketim, Fiskalizim, sherbim mirembajtje. Gjithashtu Shoqeria kerkon te bleje dhe 20 pajisje mobile dore PDA per te pajisur lexuesit e njesive Konispol dhe Finiq. Ne zbatim to Ligjit Nr. 2/2017, "Per Sigurine Kibernetike", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 553, date 15.07.2020, "Per miratimin e listes se infrastrukturave kritike te informacionit dhe te listes se infrastrukturave te rendesishme te informacionit", i ndryshuar, AK eshte percaktuar, si operator i infrastrukturave kritike dhe e rendesishme e informacionit, si rrjedhim sistemi dhe infrastruktura mbeshtetese e ofruar duhet te auditohen dhe te ofrohet perditetim i vazhdueshem nga ana e sigurise kibernetike. Zgjidhja softëerike e kerkuar duhet te jete ne Cloud.

3. OBJEKTIVAT, QELLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Pergjithshem

- ✓ *Blerje, aktivizimi Licence dhe konfigurimi zgjidhjes softëerike ne Cloud, Lexim, Faturim, Fiskalizim, Arketim dhe App mobile per PDA per nje periudhe 2 vjecare.*
- ✓ *Migrimi i te dhenave historike te SHRUKS ne programin e ri.*
- ✓ *Integrim me pale te treta nepermjet sherbimeve Eëb Service.*
- ✓ *Mirembajtje per nje periudhe 2 vjecare e programit.*
- ✓ *Te dorezoje 20 pajisjet mobile dore PDA.*

4. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit Realizimi i ketij projekti behet nen supozimin qe do te kete nje perfshirje totale te aktoreve kyç si ne implementimin e zgjidhjes softëerike ne Cloud, migrimin e te dhenave, Integrim me pale te treta nepermjet sherbimeve Eëb Service, Mirembajtje per nje periudhe 2 vjecare e programit, blerjen e pajisjeve mobile dore (PDA). Perfshirja e plote e aktoreve kyç eshte thelbesore per mbarevajtjen me sukses te projektit.

3.2. *Risqet Mos perfshirja e te gjithë aktoreve kyç do te sjelle mangesi ne zhvillim, implementim dhe funksionalitet e kerkuara si dhe ne saktesine e te dhenave.*

4. QELLIMI I PUNES

4.1. *Te pergjithshme Institucioni administrues prane te cilit do te realizohet implementimi lidhur me Zgjidhjen Softëerike ne Cloud, migrimin e te dhenave, Integrim me pale te treta nepermjet sherbimeve Eëb Service, Mirembajtje per nje periudhe 2 vjecare e programit, blerjen e pajisjeve mobile dore (PDA), do te jete Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Sarande.*

4.1.1. *Pershkrimi i detyres SHRUK Sarande Sha kerkon nga Operatori Ekonomik:*

- ✓ *Blerje, aktivizimi Licence dhe konfigurimi zgjidhjes softëerike ne Cloud, Lexim, Faturim, Fiskalizim, Arketim dhe App mobile per PDA per nje periudhe 2 vjecare.*
- ✓ *Migrimi i te dhenave historike te SHRUKS ne programin e ri.*
- ✓ *Integrim me pale te treta nepermjet sherbimeve Eëb Service.*
- ✓ *Mirembajtje per nje periudhe 2 vjecare e programit.*
- ✓ *Te dorezoje 20 pajisjet mobile dore PDA.[...]*”

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Business Solutions” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar faturë tatimore:

Nr. 669/2023, datë 08.06.2023, Nr. 957/2022 me datë 07.10.2022, Nr. 23/2023 datë 13.01.2023, Nr. 114/2023 datë 15.02.2023, Nr. 176/2022 datë 16.03.2022, Nr. 232/2022 datë 30.03.2022, Nr. 269/2023 datë 15.03.2023, Nr. 336/2022 datë 28.04.2022, Nr. 404/2023 datë 20.04.2023, Nr. 417/2022 datë 30.05.2022, Nr. 511/2023 me datë 09.05.2023, Nr. 515/2022, datë 28.06.2022, nr. 637/2022, datë 29.07.2022, nr. 773/2023, datë 07.07.2023, nr. 830/2022, datë 07.09.2022, nr. 883/2023, datë 07.08.2023, nr. 981/2023, datë 07.09.2023, nr. 1076/2022, datë 16.11.2022, nr. 1082/2022, datë 17.11.2022, nr. 1111/2023, datë 06.10.2023, nr. 1211/2022 datë 20.12.2022, nr. 1216/2023, datë 06.11.2023, nr. 1344/2023, datë 05.12.2023, nr. 57/2023, datë 30.01.2023, nr. 69/2024, datë 23.01.2024, nr. 73/2022, datë 28.01.2022, nr. 140/2022, datë 25.02.2022, nr. 196/2023, datë 28.02.2023, nr. 231/2022, datë 30.03.2022, nr. 284/2024 datë 04.03.2024, nr. 335/2022 datë 28.04.2022, nr. 340/2024, datë 21.03.2024, nr. 343/2023, datë 31.03.2023, nr. 416/2022, datë 30.05.2022, nr. 450/2021, datë 23.11.2021, nr. 477/2023, datë 28.04.2023, nr. 514/2022, date 28.06.2022, nr. 558/2021, datë 22.12.2021, nr. 628/2023, datë 30.05.2023, nr. 636/2022, date 29.07.2022, nr. 722/2023, datë 29.06.2023, nr. 795/2022, date 31.08.2022, nr. 819/2023, datë 27.07.2023, nr. 889/2022, datë 28.09.2022, nr. 931/2023, date 30.08.2023, nr. 1003/2022, date 27.10.2022, nr. 1065/2023, date 27.09.2023, nr. 1122/2022, datë 25.11.2022, nr. 1162/2023, date 25.10.2023, nr. 1258/2022, datë 23.12.2022, nr. 1281/2023, date 27.11.2023, nr. 1401/2023, date 27.12.2023, nr. 89/2022, date 07.02.2022, Nr. 06/2022, date 05.01.2022, Nr. 107/2021 datë 05.08.2021, Nr. 154/2022 datë 04.03.2022, Nr. 197/2021 datë 01.09.2021, Nr. 259/2022, datë 05.04.2022, Nr. 269/2021, datë 05.10.2021, Nr. 368/2021 datë 03.11.2021, Nr. 479/2021 datë 10.12.2021, Nr. 559/2023, date 16.05.2023, Nr. 22/2022 datë 12.01.2022, Nr. 80/2022 datë 01.02.2022, Nr. 143/2022, datë 01.03.2022, Nr. 241/2022 datë 01.04.2022, Nr. 360/2022 datë 04.05.2022, nr. 440/2022, 01.06.2022, nr. 543/2022, datë 01.07.2022, nr. 664/2022, datë 01.08.2022, nr.

820/2022, datë 01.09.2022, nr. 942/2022, datë 03.10.2022, nr. 1043/2022, datë 01.11.2022, nr. 1197/2022, datë 14.12.2022, nr. 1198/2022, datë 14.12.2022.

- Kontratë nr. 1 prot., datë 17.02.2022 me objekt “Përmirsimi i Sistemit të e-DPSHTRR dhe atij financiar sipas kërkesave për fiskalizim- për DPSHTRR”, me vlerë 50,780,000 lekë pa tvsh dhe vërtetim realizimi datë 08.06.2023.
- Kontratë nr. 9427/2 prot., datë 12.11.2021 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të administrimit të taksave”, me vlerë 910.000 lekë pa tvsh dhe fatura tatimore shitje elektronike.
- Kontratë nr. 4116/6 prot., datë 01.12.2021 me objekt “Mirëmbajtje dhe përmirsim i sistemit të taksave dhe financës”, me vlerë 1,224,000 lekë pa tvsh e vërtetuar me fatura tatimore shitje elektronike
- Kontratë nr. 42 prot, datë 21.12.2022 me objekt “Përmirsimi i sistemit të ISSH-së dhe infrastrukturës fizike-për ISSH”, me vlerë 614,308,145 lekë pa tvsh dhe vërtetim realizimi datë 17.04.2024.
- Kontratë nr. 4692 prot., datë 05.07.2021 me objekt “Mirëmbajtja e sistemit të kartesës dixhitale për të dënuarit dhe personelin”, me vlerë 18,964,800 leke pa tvsh dhe vërtetim realizimi datë 30.12.2023.
- Kontratë nr. 4721 prot., datë 06.08.2019 me objekt “Upgrade e sistemit qendror edpshttr, pajisjet HE dhe ndërtimi i sistemit të menaxhimit. Upgrade i sistemeve operative të serverave dhe databazës edpshttr. Upgrade i sistemit informatik edpshttr, përmirsim i funksionlleteve aktuale, shtim shërbimesh, për DPSHTRR”, me vlerë 100,988,920 lekë pa tvsh dhe vërtetim realizimi datë 13.12.2022.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:
Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.6. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.7. Në Nenin 92 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

III.1.8. Në nenin 41, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”.

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim.

III.1.10. Referuar shtojcës 5 “Specifikimeve teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, për projektin me objekt **“Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet”**, rezulton se autoriteti kontraktor kërkon të realizojë: Blerje, aktivizimi Licence dhe konfigurimi zgjidhjes softëerike ne Cloud, Lexim, Faturim, Fiskalizim, Arketim dhe App mobile per PDA per nje periudhe 2 vjecare. Migrimi i te dhenave historike te SHRUKS ne programin e ri. Integrim me pale te treta nepermjet sherbimeve web Service. Mirembajtje per nje periudhe 2 vjecare e programit. Te dorezoje 20 pajisjet mobile dore PDA. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE “Infosoft System” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP vëren, se operatori ekonomik në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, për përmbushjen e këtij kriteri BOE Infosoft System” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK ka dorëzuar kontrata të lidhura me institucione publike të shoqëruara me vërtetim realizimi dhe/ose fatura tatimore, si dhe fatura tatimore shitjeje të realizuara me subjekte private të listuara në pikën III.1.3 të këtij vendimi.

Referuar kontratës së bashkëpunimit (për bashkimin e përkohëshëm të operatorëve ekonomikë), datë 20.05.2024 ndërmjet shoqërisë “Infosoft System” shpk dhe Shoqërisë “Info Business Solutions” Shpk rezulton se pjesëmarrja e kompanive në bashkim e operatorëve ekonomikë do të jetë 17.31 % e angazhimit të kontratës me autoritetin kontraktor do të mbulohet nga “Infosoft Systems” shpk dhe 82.69 % e angazhimit të kontratës do të mbulohet nga “Info Business Solutions” SHPK. Referuar aneksit 1 “ndarja e punëve midis kompanive”, rezulton se shërbimi “Blerje, aktivizim licence dhe konfigurim i zgjidhjeve softëerike në cloud, lexim, faturim, fiskalizim, arkëtim dhe APP mobile për PDA për një periudhë 2 vjecare do të mbulohet 97.56 % nga “Info Business Solutions” shpk dhe 2.44 % do të mbulohet nga “Infosoft Systems” SHPK, përsa i përket zërit migrim i të dhënave do të realizohet 100 % nga InfoBusiness Solutions SHPK, zëri integrim me palë të tretë nëpërmjet shërbimeve ëeb service do të realizohet 100 % nga Info Business Solutions, zëri mirëmbajtje e zgjidhjes softëerike për një periudhë 2 vjecare do të realizohet në masën 65.75 % nga InfoBusiness Solutions SHPK dhe 34.25 % nga Infosoft systems SHPK, ndërsa zëri pajisje mobile dore PDA do të realizohet në masën 100 % nga Infosoft systems SHPK.

Referuar shtojcës 5 “Specifikime teknike” të dokumentave të tenderit, KPP konstaton se ndër të tjera është sqaruar se: *“Objektivi kryesor i kësaj kontratë është blerja e nje licence te nje zgjidhje softëerike komplekse dhe sherbime mbeshtetese ku te jene te perfshira te gjithë proceset e punes se shoqersie dhe konkretisht Lexim, Faturim, Arketim, Fiskalizim, sherbim mirembajtje. Gjithashtu Shoqeria kerkon te bleje dhe 20 pajisje mobile dore PDA per te pajisur lexuesit e njesive Konispol dhe Finiq. Nëpërmjet kësaj kontrate, autoriteti kontraktor synon: Blerje, aktivizimi Licence dhe konfigurimi zgjidhjes softëerike ne Cloud, Lexim, Faturim, Fiskalizim, Arketim dhe App mobile per PDA per nje periudhe 2 vjecare. Migrimi i te dhenave historike te SHRUKS ne programin e ri. Integrim me pale te treta nepermjet sherbimeve Eëb Service. Mirembajtje per nje periudhe 2 vjecare e programit. Te dorezoje 20 pajisjet mobile dore PDA.*

Në rastin konkret, KPP gjykon, se kemi të bëjmë me një projekt i cili në bazë ka zgjidhjet softwerike, blerje licence, shërbim mirëmbajtje, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me unifikimin e sistemit të faturimit, ku do të përfshihen dhe shërbime mbështetese konkretisht lexim, faturim, arkëtim, fiskalizim, shërbim mirëmbajtje.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të*

përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”, KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërkimit të dëshmive për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për shërbime publike ligjvënësi në nenin 41, pika 3 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e dëshmive të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushët me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i shërbimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme

Lidhur me faktin nëse fatura e dorëzuar nga BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK plotëson apo jo kriterin kualifikues të shërbimeve të ngjashme, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se lidhur me arsyen e skualifikimit sipas së cilës *Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere jo me te ulet se 40% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte: Operatori ekonomik B O E : “ (JV) Infosoft System shpk NIPT J 61820021 C & Info Business Solutions shpk NIPT L 02214022 G “ ne te gjithe kontratat e ngarkuara ne sistem nuk provon ne asnje moment sherbimet e leximit dhe te aplikacionit te leximit te pajisjeve PDA. Gjithashtu kjo B O E : “ (JV) Infosoft System shpk NIPT J 61820021 C & Info Business Solutions shpk NIPT L 02214022 G “ nuk ka paraqitur asnje kontrate te ngjashme per shitje te pajisve PDA. Te dy keto zera e mesiperme pamvarsisht % ne marrveshje ne asnje nga dokumentat nuk provojne qe kane kontrata te ngjashme te dy kompanite, Komisioni konstaton se 97.25 % të zërit nr. 1, konkretisht Blerje, aktivizim Licence dhe konfigurim i zgjidhjes softëerike ne Cloud, Lexim, Faturim, Fiskalizim, Arketim dhe App mobile per PDA per nje periudhe 2 vjecare do të realizoet nga “Info Business Solutions” shpk, në përmbushje të këtij kriteri BOE “Infosoft System” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK kanë dorëzuar kontrata të realizuara nga operatori ekonomik “Info Business Solutions” SHPK, konkretisht:*

- Kontratë nr. 1 prot., datë 17.02.2022 me objekt “Përmirsimi i Sistemit të e-DPSHTRR dhe atij financiar sipas kërkesave për fiskalizim- për DPSHTRR”, me vlerë 50,780,000 lekë pa tvsh dhe vërtetim realizimi datë 08.06.2023.
- Kontratë nr. 9427/2 prot., datë 12.11.2021 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të administrimit të taksave”, me vlerë 910.000 lekë pa tvsh dhe fatura tatimore shitje elektronike.
- Kontratë nr. 4116/6 prot., datë 01.12.2021 me objekt “Mirëmbajtje dhe përmirsim i sistemit të taksave dhe financës”, me vlerë 1,224,000 lekë pa tvsh e vërtetuar me fatura tatimore shitje elektronike, si dhe Fatura tatimore të shitjes të realizuara me kompaninë “Elektromagjia, fatura tatimore të realizuara me shoqërinë Infosoft office, fatura tatimore shitje të realizuara me shoqërinë Moncheri të listuara në pikën III.1.3 të këtij vendimi.

Lidhur me faktin nëse kontratat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Info Business Solutions” SHPK plotëson apo jo kriterin kualifikues të shërbimeve të ngjashme, KPP gjykon të ndalet dhe të analizojë 3 (tre) komponentë kumulative dhe konkretisht komponenti i vlefshmërisë; komponenti i ngjashmërisë dhe komponenti i vlerës së realizuar.

Për sa i përket vlefshmërisë së kontratave të dorëzuara, Komisioni gjykon se, kontratat e dorëzuara, si dhe faturat tatimore të shitjes janë të vlefshme për efekt të përmbushjes së kriterit kualifikues të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi, pasi vërtetimet e realizimit dhe faturat tatimore janë lëshuar brenda afatit 3 (tre) vjeçar nga data 01.03.2024 e publikimit të njoftimit të kontratës. Lidhur me komponentin e ngjashmërisë, në analizë të thelluar dhe krahasimore të kontratave të vlefshme të dorëzuara nga BOE “Infosoft System” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK të realizuara nga “Info Business Solutions” SHPK, KPP konstaton se referuar kontratës me nr. 9427/2 prot., datë 12.11.2021 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të administrimit të taksave”, kontratës nr. 4161/6 prot., datë 1.12.2021 me objekt “Mirëmbajtje dhe përmirësim i sistemit të taksave dhe financës”, kontratës nr. 1 prot., datë 17.02.2022 me objekt “Përmirësimi i Sistemit të e-DPSHTRR dhe atij financiar sipas kërkesave për fiskalizim për DPSHTRR”, si dhe faturat tatimore të listuara në pikën III.1.3 të këtij vendimi, Komisioni gjykon se me kontratat e dorëzuara, referuar kontratës dhe termave të referencës, operatori ekonomik vërteton se ka realizuar shërbime si ri-intalim dhe vënie në punë të sistemit, mirëmbajtje dhe krijim i modulit të komunikimit, komunikim me sisteme të tjera, mirëmbajtje dhe suport teknik NAV, implementim të zgjidhjeve softuerike, shërbim hostimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Info Business Solutions” SHPK me kontratat dhe faturat e dorëzuara dëshmon se ka eksperiencë të ngjashme në realizimin e shërbimeve fiskalizim, aktivizim licence, zgjidhje softuerike. Komisioni konstaton, se operatori ekonomik dëshmon se ka realizuar projekte komplekse që konsistojnë në ngritjen e sistemit të fiskalizimit, të cilat përfshijnë dhe pajisje hardware, referuar objektit të kontratës dhe se për sa i përket arsyes së skualifikimit që nuk vërteton ngjashmërinë për app mobile Komisioni gjykon se vetë app mobile është një paisje harduare dhe operatori ekonomik ankimues me kontratat e dorëzuara vërteton se ka eksperiencë në instalim, implementim zgjidhjesh softuerike.

Lidhur me komponentin e tretë, për sa i përket vlerës së kontratave të paraqitur nga ana BOE “Infosoft System” & “Info Business Solutions” SHPK të cilat përmbushin komponentin e vlefshmërisë Komisioni i Prokurimit Publik vëren se kontratat të cilat do të konsiderohen të

ngjashme Kontratë nr. 9427/2 prot., datë 12.11.2021 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të administrimit të taksave”, me vlerë 910.000 lekë pa tvsh dhe fatura tatimore shitje elektronike. Kontratë nr. 4116/6 prot., datë 01.12.2021 me objekt “Mirëmbajtje dhe përmirsim i sitemit të taksave dhe financës”, me vlerë 1,224,000 lekë pa tvsh e vërtetuar me fatura tatimore shitje elektronike, si dhe Fatura tatimore të shitjes të realizuara me kompaninë “Elektromagjia, fatura tatimore të realizuara me shoqërinë Infosoft office, fatura tatimore shitje të realizuara me shoqërinë Moncheri të listuara në pikën III.1.3 të këtij vendimi, Gjithashtu referuar kontratës nr. 1 prot., datë 17.02.2022 lidhur midis shoqërisë Info business solutions dhe autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, me objekt “Përmirësimi i sistemit të e-DPSHTRR dhe atij financiar sipas kërkesave për fiskalizim për DPSHTRR me vlerë 50,780,000 lekë pa TVSH për të cilën referuar shkresës nr. 497 prot. , datë 19.06.2024 sipas të cilës autoriteti kontraktor ka argumentuar se nuk mund të evidentohet se çfarë lloj shërbimesh ka kryer shoqëria “Info Business Solutions” SHPK si dhe nuk mund të evidentohet vlera e këtyre shërbimeve, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 84 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta”*, rezulton që për realizimin e kësaj kontrate operatori ekonomik “Info Business Solutions” SHPK është mbështetur në kapacitetet e operatorit ekonomik “Ikubinfo” shpk, ndërkohë referuar vërtetimit të realizimit të kontratës nr. 08.06.2023 lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit rezulton se Info Business Solutions SHPK do të mbulojë 100 % të kontratës ndërsa ikub info do të mbulojë 0 % të kontratës, si rrjedhojë Komisioni gjykon se BOE “Infosoft System” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK me kontratat dhe faturat e paraqitura arrin të dëshmojë kryerjen e shërbimeve të ngjashme dhe përmbush vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.1 në vlerën jo më pak se 40 % e fondit limit të kontratës objekt prokurimi, konkretisht vlera 97.56 % e cila referuar marrëveshjes së bashkëpunimit duhej të përmbushej nga operatori ekonomik “Info Business Solutions” SHPK.

Ndërsa përsa i përket kontratave të ngjashme të realizuara nga operatori ekonomik “Infosoft System” SHPK, Komisioni konstaton se ka dorëzuar kontratë nr. 42 prot., datë 21.12.2022 me objekt “Përmirësimi i sitemit të iSSH-së dhe infrastrukturës fizike për iSSH”, me vlerë 614,308,145, lekë pa tvsh, vërtetuar me vërtetim realizimi datë 17.04.2024, kontratë nr. 4692 prot. , datë 05.07.2021 me o bjekt “Mirëmbajtje e sistemit të kartesës dixhitale për të dënuarit dhe personelin”, me vlerë 18, 964,800 lekë pa tvsh, vërtetuar me vërtetim realizimi datë 30.12.2023, kontratë nr, 4721 prot., datë 06.08.2019 me objekt “Upgrade e sistemit qendror edpshttr, pajisjet HE dhe aplikimit edpshttr, ridizanjim i infrastrukturës HE dhe ndërtimi i sistemit të menaxhimit. Upgrade i sitemit informatik edpshttr, përmirësim i funksionaliteteve aktuale, shtim shërbimesh për DPSHTRR”, me vlerë 100 988 920 lekë pa tvsh dhe vërtetim realizimi kontrate datë 13.12.2022, përsa i përket komponentit të afatit të vlefshmërisë Komisioni vëren se kontratat janë realizuar brenda periudhës 3 (tre) vjeccare nga data e shpalljes së kontratës, gjithashtu përsa i përket komponentit të ngjashmërisë nga verifikimi i kontratave dhe termave të referencës Komisioni konstaton se, operatori ekonomik ka realizuar

shërbime të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, përse i përket komponentit të vlerës së kontratave të paraqitura komisioni gjykon se me kontratat e paraqitura operatori ekonomik “Infosoft System” SHPK e tejkalon vlerën jo më të vogël se 40 % e fondit limit të kontratës objekt prokurimi ku referuar kontratës së bashkëpunimit vetëm 2.44 % e zërit të parë do të mbulohej nga “Infosoft System” SHPK. Akoma më tej referuar arsyes së skualifikimit BOE “Infosoft System” SHPK & “Info Business Solution” SHPK nuk ka paraqitur asnjë kontratë të ngjashme për shitje të pajisjeve PDA, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar marrëveshjes së bashkëpunimit zëri blerje pajisje PDA do të realizohet 100 % nga operatori ekonomik “Infosoft Systems” SHPK, Komisioni gjykon se referuar ofertës ekonomike të dorëzuar nga BOE “Infosoft System” SHPK & “Info Business Solution” SHPK, zëri pajisje mobile dore PDA përbën vetëm 7 % të vlerës së ofertës ekonomike të BOE, gjithashtu referuar kontratave të dorëzuara Komisioni konstaton se operatori ekonomik “Infosoft system” SHPK ka realizuar projekte edhe më komplekse që kanë lidhje me pajisje harduare. Referuar specifikimeve teknike edhe vetë pajisjet PDA janë pajisje për leximin e matësve, sic mund të ketë edhe shumë pajisje të tjera harduare, Komisioni konstaton se, kontratat e dorëzuara të realizuara nga “Infosoft Systems” SHPK kontratë nr. 42 prot., datë 21.12.2022 të lidhur midis bashkimit të shoqërive “Infosoft System” SHPK & Data Log SHPK dhe autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me objekt “Përmirësimi i sistemit të ISSH-së dhe infrastrukturës fizike për ISSH”, me vlerë 614,308,145 lekë pa tvsh, kontratë nr. 4692 prot., datë 05.07.2021 të lidhur midis bashkimit të shoqërive “Infosoft Systems” shpk & “Ikubinfo” shpk dhe autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me objekt “Mirëmbajtja e sistemit të kartelës dixhitale për të dënuarit dhe personelin”, me vlerë 18 964 800 lekë pa tvsh, kontratë nr. 4721 prot, datë 06.08.2019 të lidhur midis bashkimit të shoqërive “Infosoft Systems” SHPK e “Ikubinfo” SHPK dhe autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me objekt “Upgrade e sistemit qendror edpshttr, pajisjet HE dhe aplikimit edpshttr, ridizanjim i infrastrukturës HE dhe ndërtimi i sistemit të menaxhimit. Upgrade i sistemeve operative të serverave dhe databazës edpshttr. Upgradei sistemit informatik edpshttr, përmirësim i funksionaliteteve aktuale, shtim shërbimesh për DPSHTRR”, me vlerë 100.988.920 lekë pa tvsh, konsiderohen kontrata të ngjashme dhe nëpërmjet tyre operatori ekonomik dëshmon se përmbush kriterin 2.3.1 “kapaciteti teknik”, të “kriterëve të veccanta të kualifikimit”, të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: *“Referuar objektit të aktivitetit të Info Business Solutions, perkatesisht pikës b. zhvillim dhe mirëmbajtje softëare. Ketu përfshihet programimi i sistemeve softëare, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që softëare-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponenteve, suporti i sistemit si një teresi komponentesh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qellimin e Zgjidhjes Informatike dhe kriterëve të shpallura për këtë prokurim, nuk shprehet në mënyrë eksplicite që aplikacioni në fjalë duhet të ketë të Emerit, apo të jete i patentuar dhe të ketë një*

emer zyrtar apo te jete nje produkt i komercializuar. Gjithashtu, ne dokumentin e specifikimeve teknike, nuk eshte kerkuar qe ky aplikacion ti referohet nje produkti/ aplikacioni te gatshem, por ne te jane listuar nje sere funksionalitetesh te cilat duhet te plotesoje ky aplikacion. Per sa me siper, Info Business Solutions ofron nje aplikacion te tille te prodhuar nga vete enti qe permbush kriteret e shpallura ne kete procedure nga institucioni. Ne kete rast vete Info Business Solutions eshte prodhuesi i aplikacionit i cili nepermjet ofertes teknike deshmon qe permbush kriteret teknike dhe funksionale te paraqitura ne kete prokurim. Gjithashtu, nepermjet dokumentit iCertificate of Authorization for the APP Mobilei te leshuar nga prodhuesi i pajisjeve PDA, konfirmohet zyrtarisht qe ky aplikacion eshte i pershtatshem per pajisjet e ofertuara. Pra, prodhuesit te pajisjeve PDA, i eshte vendosur ne dispozicion gjithë informacioni i nevojshem per te testuar pershtatshmerine me pajisjet PDA, dhe pas shqyrtimeve te bera prej prodhuesit te pajisjeve, eshte leshuar dokumenti zyrtar i depozituar si pjese e dosjes se ofertimit, ku shprehet qartesisht si me poshte: zyrtarisht qe aplikacioni eshte i pershtatshem per pajisjet e ofertuara [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” autoriteti kontraktor ka kërkuar:

2.3.5 *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/distributori i pajisjeve dhe licensave per shitjen e produkteve hardëare dhe shitjen, implementimin dhe nderhyrjen ne kodin burim te produkteve softëare të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuësit dhe Distributorit. Dokumentacioni te kete te gjithë kontaktet (nr telefoni, E-mail) si dhe adresen ëeb te prodhuësit apo Distributorit per konfirmim te dokumentave te paraqitura. Ne dokumentin e autorizimit te jene te percaktuara emri i autoritetit kontraktor, titulli dhe numri i references se kesaj procedure. Te jete e percaktuar emri, nipt dhe adresa fizike e operatorit ekonomik. Autorizimi te kete edhe daten e leshimit jo me vone nga data e zhvillimit te tenderit.*

-Ky kriter do te konsiderohet i permbushur me dorzimin e autorizimit te prodhuësit ose te distributorit te autorizuar.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “InfoSoft Systems” SHPK & “Info Business Solutions” në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Autorizim prodhuesi microsoft, datë 25.03.2024, me përmbajtje si vijon: “..Ne konfirmojmë se Info Business Solutions, me vendndodhje në rruga murat toptani, godina gjergji Center, Tirana, Shqipëri është një entitet biznesi i tillë dhe mund të ofertojë produktet Microsoft të listuara më poshtë dhe shërbimet në Shqipëri. Nav13 Nëpërmjet kësaj ne ju informojmë se microsoft lifecycle policy ofron udhëzime të qëndrueshme për gatishmërinë e suportit gjatë jetës së produktit. Detajet për Microsoft Lifecycle Policy janë të disponueshme në <https://support.microsoft.com/lifecycle>. Për produktet hardëare, ju mund ti referoheni kushteve të garancisë së hardëare-it përkatës këtu: <https://support.microsoft.com/en-us/help/4493923/ëarranties-extended-service-plans-and-termsconditions-for-your-device>.....;

- Dokumentin Certifikatë autorizimi për APP Mobile lëshuar nga shoqëria EIA SRL, datë 21.03.2024 me përmbajtje si vijon: “...Ne, EIA srl, me zyrë të regjistruar në Citta della pieve (PG) Itali, via denzlingen 10, prodhues zyrtar i PD-400, me anë të kësaj konfirmojmë APP Mobile që kompania Info Business Solutions shpk, me NIPT L02214022G, adresa: rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë 1001, Shqipëri ofron, është në përputhje për tu përdorur në pajisjet tona PDA BARCODEYES PD400 që do të përdoren në kuadër të projektit “Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet”, me numër reference REF-96925-02-29-2024 për të negociuar dhe nënshkruar kontratën në emër të tyre për qëllimin që të sigurojë modelin e mësipërm’.
- Dokumentin autorizim Prodhuesi, datë 21.03.2024 lëshuar nga shoqëria EIA srl me përmbajtje si vijon: “.....Ne, EIA srl me zyrë të regjistruar në Citta della pieve (PG) Itali, via denzlingen 10, prodhues zyrtar i PD-400, me anë të kësaj autorizojmë kompaninë Infosoft Systems shpk, me NIPT J61820021C, adresa: Rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë 1001, Shqipëri dhe kompania Info Business Solutions shpk me NIPT L02214022G, adresa: rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë 1001, Shqipëri të dorëzojë një ofertë për projektin “Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet”, me numër reference REF-96925-02-29-2024, qëllimi i të cilës është të sigurojë mallrat e mëposhtme të prodhuara nga ne:
PD-400 Rugged PDA.

III.2.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.4. Neni 41 pika 2 dhe 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.2.6. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në interpretim të kriterit të mësipërm, vërejmë se autoriteti kontraktor ka kërkuar, konkretisht: *“Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/distributori i pajisjeve dhe licensave për shitjen e produkteve hardëare dhe shitjen, implementimin dhe ndërhyrjen në kodin burim të produkteve softëare të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit. Dokumentacioni të kete te gjithe kontaktet (nr telefoni, E-mail) si dhe adresen eeb te prodhuesit apo Distributorit per konfirmim te dokumentave te paraqitura. Ne dokumentin e autorizimit te jene te percaktuara emri i autoritetit kontraktor, titulli dhe numri i references se kesaj procedure. Te jete e percaktuar emri, nipt dhe adresa fizike e operatorit ekonomik. Autorizimi te kete edhe daten e leshimit jo me vone nga data e zhvillimit te tenderit.*

-Ky kriter do te konsiderohet i permbushur me dorzimin e autorizimit te prodhuesit ose te distributorit te autorizuar”. Pra në interpretim të kriterit të mësipërm autoriteti kontraktor ka ndarë në tre momente përse i përket paraqitjes së autorizim prodhuesi/ distributori, konkretisht ka kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë: autorizim nga prodhuesi/distributori i pajisjeve dhe licensave për shitjen e produkteve hardëare, si dhe shitjen, implementimin dhe ndërhyrjen në kodin burim të produkteve software të përfshira në këtë objekt prokurimi.

Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK konstatohet se ky i fundit ka paraqitur: Autorizim prodhuesi microsoft, datë 25.03.2024, me përmbajtje si vijon: *“..Ne konfirmojmë se Info Business Solutions, me vendndodhje në rruga murat toptani,*

godina gjergji Center, Tirana, Shqipëri është një entitet biznesi i tillë dhe mund të ofertojë produktet Microsoft të listuara më poshtë dhe shërbimet në Shqipëri. Nav13 Njëpërmjet kësaj ne ju informojmë se microsoft lifecycle policy ofron udhëzime të qëndrueshme për gatishmërinë e suportit gjatë jetës së produktit. Detajet për Microsoft Lifecycle Policy janë të disponueshme në <https://support.microsoft.com/lifecycle>.

Për produktet hardëare, ju mund ti referoheni kushteve të garancisë së hardëare-it përkatës këtu: <https://support.microsoft.com/en-us/help/4493923/ëarranties-extended-service-plans-and-termsconditions-for-your-device>.....;

Dokumentin Certifikatë autorizimi për APP Mobile lëshuar nga shoqëria EIA SRL, datë 21.03.2024 me përmbajtje si vijon: “...Ne, EIA srl, me zyrë të regjistruar në Citta della pieve (PG) Itali, via denzlingen 10, prodhues zyrtar i PD-400, me anë të kësaj konfirmojmë APP Mobile që kompania Info Business Solutions shpk, me NIPT L02214022G, adresa: rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë 1001, Shqipëri ofron, është në përputhje për tu përdorur në pajisjet tona PDA BARCODEYES PD400 që do të përdoren në kuadër të projektit “Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet”, me numër reference REF-96925-02-29-2024 për të negociuar dhe nënshkruar kontratën në emër të tyre për qëllimin që të sigurojë modelin e mësipërm’

Dokumentin autorizim Prodhuesi, datë 21.03.2024 lëshuar nga shoqëria EIA srl me përmbajtje si vijon: “.....Ne, EIA srl me zyrë të regjistruar në Citta della pieve (PG) Itali, via denzlingen 10, prodhues zyrtar i PD-400, me anë të kësaj autorizojmë kompaninë Infosoft Systems shpk, me NIPT J61820021C, adresa: Rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë 1001, Shqipëri dhe kompania Info Business Solutions shpk me NIPT L02214022G, adresa: rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë 1001, Shqipëri të dorëzojë një ofertë për projektin “Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet”, me numër reference REF-96925-02-29-2024, qëllimi i të cilës është të sigurojë mallrat e mëposhtme të prodhuara nga ne:

PD-400 Rugged PDA, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar Komsioni i Prokurimit Publik gjykon se BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Business Solutions” SHPK vërteton se ka paraqitur autorizim prodhuesi për paisjen PD-400 Rugged PDA, si dhe dokumentin autorizim prodhuesi Microsoft, duke vërtetuar në këtë mënyrë që përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të shtojcës 8 të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Business Solutions” SHPK qëndron.

III. 3. Lidhur me pretendimin e BOE “Infosoft System” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit me arsyetimin se: “Per piken e pare te referuar ne kete sqarim, ku pretendohet nga Autoriteti se ñne dokumentacionin e paraqitur nga ana e prodhuesit me ane te nje deklarate nuk cilesohet aplikacioni qe eshte ne perputhje me pajisjen qe ofron prodhuesi per kete procedure pavarisisht qe presupozohet qe ky aplikacion ka kaluar te gjithë testet per kete pajisjei, specifikuar se deklarata nuk cileson aplikacionin qe eshte ne perputhje me pajisjen qe ofron prodhuesi per kete procedure fillimisht sjellim ne vemendjen e Autoritetit se kriteret per kualifikim jane vendosur nga vet autoriteti dhe ofertuesit i permbushin ato sipas kerkeses. Ne DST eshte kerkuar specifikisht i2.3.6APP mobile i lexuesve duhet te jete i certifikuar per pajisjen PDA te ofertuar. -Ky kriter do te konsiderohet i

permbushur me dorezimin deklarates dhe certifikimit nga prodhuesi i PDA. Referuar Nenit te VKM 2.Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme, nenit 92 te LPP-se 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, ne kemi paraqitur pikerisht deklaraten e kerkuar ku vertetohet kerkesa e shkruar ne DST nga autoriteti. Referuar termit te perdorur nga vete autoriteti kontraktor, ne DST, dhe shtojcat perkatese, konkretisht TABELA E CMIMEVE TE SHERBIMEVE, zeri 1, referohet togfjaleshi iApp mobile per PDA?. 1 Blerje, aktivizim Licence dhe konfigurim i zgjidhjes softëerike ne Cloud, Lexim, Faturim, Fiskalizim, Arketim dhe App mobile per PDA per nje periudhe 2 vjecare. Sic mund te verifikohet qarte, edhe certifikata e autorizimit te leshuar nga prodhuesi i PDA iCertifikate Autorizimi per APP Mobilei, cituar me poshte, i eshte referuar sakesisht terminologjise se perdorur nga AK iAPP Mobilei”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik” autoriteti kontraktor ka kërkuar:

2.3.6 *APP mobile i lexuesve duhet te jete i certifikuar per pajisjen PDA te ofertuar.*
-Ky kriter do te konsiderohet i permbushur me dorezimin deklarates dhe certifikimit nga prodhuesi i PDA.

Shenim :

Zgjidhja softëerike ne cloud e ofertuar nga OE mund te jete nje produkt i vetem ose te jene disa produkte te integruara mes tyre per te realizuar te gjitha kerkesat e parashikuara ne specifikimet teknike.

Te gjitha dokumentet duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes se nje dokumenti, ose dokumente false dhe te pasakta, konsiderohen kushte per skualifikim.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “Info Systems” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Dokumentin Certifikatë autorizimi për APP Mobile lëshuar nga shoqëria EIA SRL, datë 21.03.2024 me përmbajtje si vijon: “...Ne, EIA srl, me zyrë të regjistruar në Citta della pieve (PG) Itali, via denzlingen 10, prodhues zyrtar i PD-400, me anë të kësaj konfirmojmë APP Mobile që kompania Info Business Solutions shpk, me NIPT L02214022G, adresa: rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë 1001, Shqipëri ofron, është në përputhje për tu përdorur në pajisjet tona PDA BARCODEYES PD400 që do të përdoren në kuadër të projektit “Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për

dy vjet”, me numër reference REF-96925-02-29-2024 për të negociuar dhe nënshkruar kontratën në emër të tyre për qëllimin që të sigurojë modelin e mësipërm’

III.3.3 Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.4. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

Referuar shtojcës 7 “Formulari i termave të referencës”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, për projektin me objekt ‘**Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet**’, **autoriteti kontraktor ka kërkuar** realizimi i këtij projekti që do të ketë një përfshirje si në implementimin e zgjidhjes softwerike në Cloud, migrimin e të dhenave, Integrim me pale të treta nëpërmjet shërbimeve web Service, Mirëmbajtje për një periudhë 2 vjeçare e programit, blerjen e pajisjeve mobile dore (PDA).

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP vëren, se

operatori ekonomik në përmbushje të kriterit kualifikues ka dorëzuar Dokumentin Certifikatë autorizimi për APP Mobile lëshuar nga shoqëria EIA SRL, datë 21.03.2024 me përmbajtje si vijon: *“....Ne, EIA srl, me zyrë të regjistruar në Citta della pieve (PG) Itali, via denzlingen 10, prodhues zyrtar i PD-400, me anë të kësaj konfirmojmë APP Mobile që kompania Info Business Solutions shpk, me NIPT L02214022G, adresa: rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë 1001, Shqipëri ofron, është në përputhje për tu përdorur në pajisjet tona PDA BARCODEYES PD400 që do të përdoren në kuadër të projektit “Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet”, me numër reference REF-96925-02-29-2024 për të negociuar dhe nënshkruar kontratën në emër të tyre për qëllimin që të sigurojë modelin e mësipërm”*, nga verifikimi i të cilës Komisioni konstaton se, shoqëria EIA SRL prodhues i PD-400 konfirmojnë që APP Mobile është në përputhje për tu përdorur në pajisjet PDA BARCODEYES PD400 që do të përdoren në kuadër të projektit “Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet”, Komisioni gjykon se, me dokumentacionin e dorëzuar operatori ekonomik ka dhënë një indicie që përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.6 të shtojcës 8 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në rastin konkret, nisur nga arsyeja e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues me arsyen, se *[...] Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin deklarates dhe certifikimit nga prodhuesi i PDA. Operatori ekonomik B O E : “ (JV) Infosoft System shpk NIPT J 61820021 C & Info Business Solutions shpk NIPT L 02214022 G “ ne dokumentacionin e paraqitur nga ana e prodhuesit me ane të një deklaratë nuk cilesohet aplikacioni që është në përputhje me pajisjen që ofron prodhuesi për këtë procedurë pamvarsisht që prezupozohet që ky aplikacion ka kaluar të gjithë testet për këtë pajisje. Gjithashtu Operatori ekonomik B O E : “ (JV) Infosoft System shpk NIPT J 61820021 C & Info Business Solutions shpk NIPT L 02214022 G [...], Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:*

- i. *“Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*
- ii. *“Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe*
- iii. *“Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, autoriteti kontraktor nëse kishte dyshime, apo pamundësi për të verifikuar dokumentin e ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konkretisht dokumentin autorizim prodhuesi datë 21.03.2024, duhet t’i kërkonte sqarime BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK.

Sa më sipër, bazuar në ligjin “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kualifikojë BOE “Infosoft Systems” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK, si dhe t’i kërkojë sqarime lidhur dokumentin autorizim prodhuesi datë 21.03.2024, të dorëzuar nga operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.5, shtojcës 8, të dokumenteve të tenderit.

Lidhur me arsyen e skualifikimit se: “*Sipas skedes teknike e marre nga faqa zyrtare e kompanise prodhuese e cila ka leshuar dhe autorizimin, kjo pajisje nuk ploteson specifikimet si me poshte:*

- *Mbrojtja IP68 (kerkuar) ne skede eshte 67*
- *Sensor Drite- Po (ne skede nuk eshte)*
- *Sensor Graviteti – Po (ne skede nuk eshte)*
- *Sensor Distance (ne skede nuk eshte)*
- *Sensor per fushe manjetike – Po (ne skede nuk eshte)*
- *Sensor Giroskopi – Po (ne skede nuk eshte)*
- *Minimumi distances se funksionimit te Scannerit 1 m. (ne skede nuk eshte)*
- *Card Slot: Nano SIM + SIM + Micro SD (ne skede nuk eshte Nano Sim)*
- *ËiFi: 2.4Ghz/5Ghz/IEEE 802.11 (ne skede nuk perfshihet 5 Ghz qe eshte Ëifi me perdorshimi ne keto momente)*
- *Mikrofon: Po (ne skede nuk eshte)*
- *Port: Type C (ne skede nuk eshte)*
- *Camera: ≥13MP Mbrapa/ ≥5MP Para (ne skede eshte vetem 5MP mbrapa, para eshte 0)*
- *Pesha: <245gr (ne skede 260)*
- *Bateria te jete te pakten 3,8V/5000mAh (ne skede eshte 3,7V)*
- *Pajisja te jete rezistente nga uji deri ne 1.2 metra thellesi (ne skede nuk eshte)*

Edhe pse ne dokumenta eshte vendosur dhe nje MAF per operatorin IBS i cili ne % e marrveshjeve nuk ka asnje rol per kete sherbim, edhe ky MAF nuk ploteson specifikimet teknike.”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nga verifikimi i dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar dorëzimin e katalogut apo skedës teknike për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike. Komisioni gjykon, se në cdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, mbi bazën e të cilëve më pas edhe KVO do të bëjë vlerësimin e ofertave të dorëzura nga operatorët ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e BOE “Infosoft System” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-96925-02-29-2024 me objekt “Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet” me fond limit 15,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21-05-2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë verifikimet lidhur me dokumentacionin e arsyes së skualifikimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik dhe më pas të vijojë me rivlerësimin e procedurës objekt-ankimi.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Infosoft System” SHPK & “Info Business Solutions” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

